

## Rikonstrukcioni i kompleksit të godinave ruan traditën e ndërtimit.

---

Rikonstrukcioni i godinave në hyrje të portit detar të Durrësit ka ruajtur një pjesë të traditës së ndërtimit të dekadave të para të shekullit të kaluar në zonën historike të qytetit bregdetar.

Realizimi i projektit të Autoritetit Portual përfundon pas disa ditësh dhe kap vlerën prej afro 83 milion lek.

Bashkë me fasadat e dy godinave qendore të drejtorisë së portit që janë ndërtuar në mesin e viteve 1930 është restauruar plotësisht me të njejtin fond edhe fasada e godinës së njohur në vitet 1970 si Interklubi. Ndërtesat në hyrjen kryesore të portit janë ngritur mbi bazën e një plani rregullues urbanistik menjëherë pas tërmetit të vitit 1926 në qytetin antik, plan sipas të cilit Rruga Tregtare që niste nga bashkia e qytetit do të përfundonte në kompleksin e godinave portuale.

Zëvendësimi i pllakave të terrakotës sipas modelit të viteve 1930 ka ruajtur identitetin e godinave në faqet e jashtme, ndërsa rikonstrukcioni i brendshëm që ka përfshirë një sipërfaqe prej 2350 metra katrorë do të bëjë funksionale dhe moderne mjediset ku do të rikthehen së shpejti të gjitha funksionet e zhvendosura përkohësisht në një ndërtesë tjetër.

Në godinën e ish-Interklubit ka përfunduar ndërtimi i mjediseve për një shkollë me 12 klasa dhe një sallë konferencash për trajnime të specializuara.

Në katin e parë të së njejtës godinë është parashikuar pajisja e mencës së punonjësve si dhe funksionimi i 6 zyrave të agjencive të ndryshme në shërbim të qytetarëve.

Projekti i rikonstrukcionit të kompleksit të godinave portuale është zbatuar nga firma “Eurondërtim 2000”